



Numëri i Dokumentit Pavarur/Number Document of Authority	22 - 11	2021	1	viti год year
Organ Përcjellës Organ Address Org. Code	SKUMVSHKX	5586/2021	Shërbimi Slужba Service	Suma Kolicina Quantity
				116



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.884/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.884/2021 të datës 15.10.2021 të parashtruar nga Kryetari i Shoqatës Sindikale të Shërbyesve Civil në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me adresë rruga "Rexhep Krasniqi", Hyrja 4, Kati 5, Lagja Kalabri në emër të ankuesve

kundër organit të punësimit/
Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.884/2021 e datës 25.10.2021 e ankuesve:

dhe e parashtruar përmes Bekim Samadraxha Kryetari i Shoqatës Sindikale të Shërbyesve Civil në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesve

cilët i përfaqëson Kryetari i Shoqatës Sindikale të Shërbyesve Civil në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

A r s y e t i m

Kryetari i Shoqatës Sindikale të Shërbyesve Civil në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në emër të ankuesve, me datë 25.10.2021, ka parashtruar ankesë me numër protokoli 5150/2021 të regjistruar me numër A.nr.884/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensim të shpenzimeve për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punës sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.10.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Këshilli me datë 09.11.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ndërsa më datë 09.11.2021 kemi kërkuar përgjigje në ankesë edhe nga Inspektorati i Arsimit. Inspektorati i Arsimit më datë 11.11.2021 është përgjigjur në kërkesën e dërguar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 5150/2021 të regjistruar me numër A.nr.884/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës

17.05.2021 për Ushtruesin e Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në MASHTI; Ankesën e datës 18.06.2021 të parashtruar për Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave në MASHTI; Kërkesën për lejimin në qasjen e aktit administrativ të miratuar në heshtje e datës 27.07.2021 për Zëvendësuesen e Sekretares në MASHTI; Emailin e datës 15.09.2021 nga

Lista e Anëtarëve të Sindikatës në MASHTI që kërkojnë pagesën e shujtës; Vërtetim i Marrëdhënies së punës Ref:4/4-55 i datës 30.09.2021; Vendimin e datës 04.04.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale; Statutin e Shoqatës Sindikate të Shërbimit Civil të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë i datës 20.02.2019; Lista e anëtarëve të Kryesisë së Shoqatës Sindikale të Shërbyesve Civil të MASHTI i datës 24.02.2019; Deklaratat e anëtarëve të Shoqatës Sindikale të Shërbimit Civil në MASHTI; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.10.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 09.11.2021; Akt Emërimin e datës 07.50.2012 për Akt Emërimin e datës 06.02.2012 për Akt Emërimin e datës 07.50.2021 për Akt Emërimin e datës 01.08.2011 për Akt Emërimin e datës 28.11.2011 për ; Akt Emërimin e datës 01.09.2011 për Akt Emërimin e datës 02.04.2012 për Akt Emërimin e datës 03.09.2013 për Akt Emërimin e datës 30.09.2013 për M. Akt Emërimin e datës 04.05.2012 për Akt Emërimin e datës 02.07.2014 për Akt Emërimin e datës 19.03.2013 për Akt Emërimin e datës 11.05.2012 për Akt Emërimin e datës 07.05.2012 për Akt Emërimin e datës 04.05.2012 për Akt Emërimin e datës 05.09.2011 për Akt Emërimin e datës 02.04.2012 për Akt Emërimin e datës 07.05.2012 për Akt Emërimin e datës 04.05.2012 për Akt Emërimin e datës 24.05.2013 për Akt Emërimin e datës 04.05.2012 për Akt Emërimin e datës 26.09.2011 për Akt Emërimin e datës 31.05.2012 për Akt Emërimin e datës 11.05.2012 për Akt Emërimin e datës 03.05.2012 për Akt Emërimin e datës 11.05.2012 për F. Akt Emërimin e datës 07.05.2012 për Akt Emërimin e datës 04.05.2012 për Akt Emërimin e datës 17.06.2013 për Akt Emërimin e datës 14.05.2012 për Akt Emërimin e datës 16.05.2012 për Akt Emërimin e datës 07.05.2012 për Akt Emërimin e datës 30.03.2015 për Akt Emërimin e datës 25.02.2013 për Akt Emërimin e datës 11.05.2012 për E. Akt Emërimin e datës 16.08.2013 për Akt Emërimin e datës 04.05.2012 për Akt Emërimin e datës 12.12.2011 për Akt Emërimin e datës 10.05.2012 për Akt Emërimin e datës 23.03.2012 për Kërkesën e datës 09.11.2021 për nga KPMSHCK; Përgjigjen e datës 11.11.2021 nga Inspektorati i Arsimit; Akt Emërimin e datës 07.10.2016 për Akt Emërimin e datës 03.05.2012 për Akt Emërimin e datës 04.05.2012 për Akt Emërimin e datës 06.06.2012 për Akt Emërimin e datës 20.02.2017 për Akt Emërimin e datës 07.10.2012 për Akt Emërimin e datës 16.07.2013 për Akt Emërimin e datës 04.05.2012 për Akt Emërimin e datës 12.03.2013 për Akt Emërimin e datës 24.02.2011 për Akt Emërimin e datës 03.08.2016 për Akt Emërimin e datës 15.07.2013 për Kontratë Punë për Akt Emërimin e datës 07.05.2012 për Akt Emërimin e datës 10.05.2012 për Akt Emërimin e datës



10.05.2012 për	Akt Emërimin e datës 03.08.2016 për	Kontratë Pune
për	Akt Emërimin e datës 30.11.2011 për	Akt Emërimin e datës
01.06.2012 për	Akt Emërimin e datës 01.06.2012 për	Kontratë Punë për
	Akt Emërimin e datës 11.05.2012 për	akt Emërimin e datës 07.05.2012
për	Akt Emërimin e datës 24.01.2017 për	Akt Emërimin e datës
11.05.2012 për	Akt Emërimin e datës 11.05.2012 për	Akt Emërimin e
datës 17.01.2014 për	Kontratë Pune për	Akt Emërimin e datës
17.01.204 për	Akt Emërimin e datës 11.05.2012 për	Akt Emërimin e
datës 03.08.2016 për	Akt Emërimin e datës 24.10.2011 për	Kontratë
Pune për	Akt Emërimin e datës 11.05.2012 për	Akt Emërimin e datës
11.05.2012 për	Akt Emërimin e datës 11.05.2012 për R.	Akt Emërimin e
datës 11.5.2012 për	Kontratë Pune për	Akt Emërimin e datës
11.05.2012 për	Kontratë Punë për	

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesve si në pikën e I të dispozitivit të këtij vendimi, është e **pabazuar, sepse:**

Kryetari i Shoqatës Sindikale të Shërbyesve Civil në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në emër të ankuesve më datë 17.05.2021 ka parashtruar kërkesë tek Ushtruesi i detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për kompostimin e shujtës ditore sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive, mirëpo në bazë të provave të lëndës nuk kanë pranuar përgjigje në kërkesë, ndërsa më datë 18.06.2021 kanë parashtruar ankesë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, mirëpo nuk kanë marr përgjigje. Më datë 27.07.2021 kanë parashtruar kërkesë tek zëvendësuesja e Sekretares së Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për lejimin në qasjen në aktin administrativ të miratuar në heshtje mirëpo nuk kanë marr përgjigje.

Kryetari i Shoqatës Sindikale të Shërbyesve Civil në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në ankesën e parashtruar në emër të ankuesve pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon njohjen e të drejtës për kompensim të ushqimit gjatë punës për ditët e pranisë në punës sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilin janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesve dhe ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 38/2014 më datë 18.06.2014, ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo më shumë se tri (3) vite, respektivisht deri më datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017.

Bazuar në konstatimin e lartcekur dhe në kuptim të nenit 87 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesve si në pikën 1 të dispozitivit të këtij vendimi për realizimin e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit gjatë punës për ditët e pranisë në punës është parashkruar, kështu që pretendimi i ankuesve mbi këtë bazë ligjore është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin të Kosovës, është jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesve si në pikën 2 të dispozitivit të këtij vendimi, *sepse:*

Ankuesit

marerëdhënien e tyre të punës e kanë lidhur përmes kontratave të punës referuar Ligjit Nr.03/L-212 të Punës në pozitën "Pastrues", ndërsa ankuesit dhe në bazë të akt Emërimeve mbajnë pozitë "Zyrtar i Transportit" respektivisht "Asistent i Transportit", bazuar në këtë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se këto pozita në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë konkretisht nenit 2 paragrafi 2.4 hyjnë në kategorinë e nëpunësve administrative teknik dhe mbështetës ku përcaktohet se *Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike* dhe si rrjedhojë ankuesit si në pikën 2 të dispozitivit nuk e kanë statusin e Nëpunësit Civil, kështu që duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesi ka statusin e Nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se Nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.884/2021

Aydyl BEKTESHI

Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Kryetari i Shoqatës Sindikale të Shërbyesve Civil në MASHTI;
- Sekretarit të Përgjithshëm të MASHTI-të;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Arsimit;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në MASHTI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

